



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 29 shkurt 2016

Numri i lëndës: 2015-03

Dekard Shkololli

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 shkurt 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 20 prill 2015.

II. FAKTET

2. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga ankuesi, mund të përmblihen si në vijim.
3. Ankuesi ishte shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim në Gjermani, edhe pse nuk ofron asnjë hollësi rreth natyrës së dënimit.
4. Ankuesi ka një djalë, lindur në vitin 1997, ku siç duket jeton në Gjermani. Ankuesi është ndarë nga ai që nga viti 2004.

III. ANKESAT

5. Ankuesi pohon se ishte dënuar dhe burgosur në mënyrë të padrejtë. Po ashtu duket që ankohet se është ndarë nga djali i vet dhe kërkon të bashkohet me të. Ai kërkon kompensim për padrejtësinë që ai thotë se ka pësuar.

IV. LIGJI

6. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
7. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
8. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
9. Paneli vëren se ankesa e ankuesit duket se ka të bëjë me procedurat penale pranë gjykatave në Gjermani dhe arresti i tij atje. Po ashtu duket se ka të bëjë me përkujdesjen e djalit të tij. Nuk është argumentuar e leje më treguar se EULEX-i është përfshirë në ndonjë cilësi në këto çështje.

10. Prandaj kjo ankesë bie jashtë kuadrit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe si rrjedhojë jashtë kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë (shih [Qerim Beqolli kundër EULEX-it](#), 2014-27, 2 shkurt 2015, § 12, [Mensur Fezaj kundër EULEX-it](#), nr. 2014-20, 26 gusht 2014, §§ 9-10).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se ankesa qartas është e pabazuar sa i përket nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK
Zyrtare ligjore

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese